

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtarës së vetëme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit U.M. nga ..., për shkak të veprës penale lëndim I lehtë trupor nga neni 153 parag. 1 nënpar. 4 të KPK-së, duke vendosur sipas propozim akuzës së PPK-së nga Gjilani, PP.nr.1440/2012 të dt.08.08.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurores së Shtetit Bahtije Ademi, të akuzuarit U.M., më datën 11.02.2015 shpall publikisht, ndërsa më datën 23.02.2015 përpiloi këtë,

A K T G J Y K I M

I akuzuari U.M., në bazë të evidencës që disponon gjykata, i pa dënuar më parë për vepër tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale,

Është fajtorë

Më datë 24.07.2012, rreth ores 17.10 min, në ... , në lagjen "...”te xhamia, i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore XH.I. nga ..., në atë mënyrë që të njëjtën e kap për duarsh dhe më pas me këmbë, gjunjë dhe grushta e godet nëpër të gjithë trupin dhe në këtë mënyrë të njëjtit i shkaktonte lëndime të lehta trupore të përshkruara si në raportin mjekësor të QKMF-së në nr.11106 të datës 24.07.2012 të lëshuar në emër të të dëmtuarit, të vërtetuar me ekspertizën mjeko ligjore të dt.16.01.2015.

- me çka ka kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 parag. 1 nënpar.4 të KPK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,41, 46, 73, 74 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarin,

e g j y k o n

Me dënim gjobe (në të holla) në shumë prej 200 €, të cilën shumë i akuzuari ka për ta paguar, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit apo në të kundërtën të njëjtit do t'i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim burgu ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burgu.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale , për ekspertizën mjeko-ligjore të paguaj shumën prej 80.00 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Gjilan, me propozim akuzën PP.nr.1440/2012 të dt.08.08.2012, ka akuzuar U.M. nga Kamenica, për shkak veprës penale lëndim I lehtë trupor nga neni 153 parag. 1 nënpar. 4 të KPK-së, ku edhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur pranë propozim akuzës me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin.

I akuzuari U.M. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se, ditën konkrete pas faljës së namazit të ikindisë është ofruar te i dëmtuari tani i ndjeri për ta pyetur lidhur me një mosmarrëveshje që ka pasur i dëmtuari me gjyshin e tij, gjithëashtu i njëjti na është kanosur, na ka fyer afër shtëpis për të cilën gjë e kemi lajmëruar policin, mohon që se ditën konkrete ta ketë goditur të dëmtuarin, me të njëjtin nuk ka pasur më kontakte, ndërsa gjyshi I tij me të dëmtuarin janë pajtuar.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari nuk e ndien vehtën fajtor se ka kryer këtë vepër penale dhe kërkon nga gjykata që ta liroj nga përgjegjësia penale,

Gjykata në procedurën provuese ka dëgjuar dëshmitarët si dhe ka bërë shiqimin dhe leximin e provave materiale bashkangjitur lëndës si: raportin e mjekut të QKMF-së me nr.11106 të dt. 24.07.2012, ekspertiza mjeko ligjore me numër të references 03/01-15 dt 16.01.2015, si dhe është lexuar deklarata e të dëmtuarit tani i ndjerit XH.I.

Dëshmitari H.M., në dëshmin e tij ka deklaruar, është hoxhë i xhamisë ditën konkrete ka ndëgjuar një zhurmë jashtë oborrit të xhamisë ka dalur të shoh se ç'po ndodh, pasi ka pengesa në të pamur nuk ka pare asgjë , mirëpo ka ndëgjuar nga xhemati i xhamisë se ka pasur një zënkë në mes të XH.I. dhe nipit të H.-U., para këti rasti Xh.I. ka pasur një mosmarrëveshje me gjyshin e të akuzuarit H., si imam I xhamisë së bashku me S.G.kanë shkuar te XH. tani i ndjeri për ti pajtuar, I cili u ka thenë se pas goditjes që ka marr nga Urani ka shkuar te mjeku, sa e ka njohur të ndjerin nuk ka qenë person agresiv, vetëm ka pasur dëshirë të bëjë shaka.

Dëshmitari R.R. në dëshmin e tij ka deklaruar, se ditën kritike pasi kanë dalur nga xhamia përafërsisht 200 m larg ka parë duke biseduar XH. me U. për një mosmarrëveshje që ka pasur Xh me gjyshin e U, ka qenë 3-4 metra larg nga personat që janë grindur ku nuk ka mund të shoh krejt çka ka ndodhur, vetëm ka pare se të dytë Xh. dhe U. i kanë pasur duart lartë, mirëpo personalisht nuk e ka pare se U. ta ketë goditur Xh., pasi në mes tyre ka pasur disa persona. Pas këtij incidenti I akuzuari dhe I dëmtuari janë pajtuar dhe më asnjëherë nuk kanë pasur mosmarrëveshje.

Pasi që i dëmtuari XH. I. ka ndërruar jetë e këtë gjë e vërtetoi imami i xhamisë H. M., prokurorja e shtetit propozoi që të lexohet deklarata e të dëmtuarit dhënë në polici më dt 24.07.2012, i cili ka deklaruar me të dalur nga xhamia është sulmuar nga U. e kjo ka ndodhur si pasojë e raporteve jo të mira me gjyshin e tij , për lëndimet që ju janë shkaktuar i njëjti ka raport mjekësor.

Nga shkresat e çështjes dhe nga provat që janë proceduar në këtë çështje penale juridike, nuk janë kontestuese faktet: se jashtë oborrit të xhamisë i akuzuari ka pasur një mosmarrëveshje me të dëmtuarin tani i ndjer

Xh. I., gjatë kësaj mosmarrëveshje i akuzuari i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit Xh. I. duke e goditur të njëjtin.

Gjykata ia ka falur besimin deklaratës të të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit dhenë në polici më dt. 24.07.2012, në të cilën deklaratë përshkruhet se si i akuzuari Uran e ka goditur të njëjtin dhe nga goditjet e marra i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe është detyruar të lajmërohet në QKMF në Kamenicë për marrjen e ndihmës mjeksore, kjo u vërtetua edhe me ekspertizën mjeko-ligjore në të cilën është konstatuar se i dëmtuari Xh .I., ka pësuar këto dëmtime të cilat paraqesin: gërvishje në regjionin e hundës dhe në regjionin e të dy duarëve si dhe palgë në pjesën dorzale të dorës së majtë lëndime të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mbrehtë) që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohëshme për shëndetin, pra provat e shqyrtuara në shqyrtim gjyqësore dhe deklaratat e të dëmtuarit ishin në përputhshmëri të plotë në mes veti.

Nga deklaratat e dëshmitarit H. M. imam i xhamisë u provua se U. dhe Xh. kanë pasur një mosmarrëveshje e për të cilën mosmarrëveshje i njëjti së bashku me një person tjetër (S. G.) kanë shkuar për ti pajtuar dhe nga i dëmtuari tani i ndjer ka kuptuar se pas goditjes që ka marrë nga Urani është detyruar të shkon te mjeku, gjithëashtu edhe nga deklaratat e dëshmitarit R. R. është vërtetuar se ditën konkrete i akuzuari dhe i dëmtuari kanë pasur një mosmarrëveshje, të dytë kanë pasur duartë lartë, mirëpo nuk ka mundur ta shoh krejt situatën , se a është goditur i dëmtuari apo jo.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit, i cili nuk kontestoi se ka pasur mosmarrëveshje në mes tij dhe të dëmtuarit mirëpo i njëjti mohoi të ketë goditur të dëmtuarin tani i ndjer, andaj mbrojtjes së tij gjykata nuk ia fali besimin pasi e konsideron të pa bazuar dhe në kundërshtim me të gjitha provat e shtjelluara e këtë e ka bërë me qëllim që t'i shmanget përgjegjësisë penale për veprën për të cilën akuzohet .

Nga faktet që u parashtruan më parë, qartë rezulton se janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 parag. 1 nënparag.4 të KPK-së.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit konform nenit 74 të KPPRK-së gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat në rastin konkret kanë ndikim që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rëndë.Si rrethana lehtësuese gjykata të akuzuarit i ka marrë për bazë, sjelljen korrekte në gjykatore, moshën relativisht të re, bashkëpunues me gjykatën, është hera e parë që është ndeshur me ligjin, nuk zhvillohet procedure tjetër penale , andaj duke mos gjetur ndonjë rrethanë veçanarisht rënduese të akuzuarit i ka shqipëtuat dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka vlersuar se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, ashtu që do të bëjë rehabilitimin e kryerësit e poashtu edhe do ti parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të ngrisë forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në përgjithësi.

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 450 parag. 2 nënparag. 2.6 lidhur me nenin 453 parag. 1 i KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN-DEGA NE KAMENICE-

Më datën 23.02.2015. P.222/2012

Sekretarja juridike,

G j y q t a r j a,

Emine Zubaku,d.v.

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.